



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 152

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 25 tetor 2018

PËRMBAJTJA

	Page
Ligj nr. 67/2018 datë 4.10.2018	Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” 10183
Ligj nr. 68/2018 datë 4.10.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe të programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV” 10183
Ligj nr. 69/2018 datë 11.10.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar..... 10184
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 9.10.2018	Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë..... 10187
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 698, datë 17.10.2018	Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për ngritjen dhe uljen e helikopterëve jashtë zonave të aerodromeve të Republikës së Shqipërisë..... 10191
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 435, datë 17.10.2018	Për tërheqjen e njohjes së Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP, Liqeni i Fierzës, Kukës)..... 10197
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 657, datë 28.9.2018	Për delegim kompetence..... 10197

Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 17079, datë 18.10.2018	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje dypalëshe me Austrinë.....	10198
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 12939, datë 18.10.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikualifikimi urban i rrugës “Ramiz Aranitasi”, Fier.....	10198
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 9246/3, datë 24.10.2018	Për shpronësim, marrjen në përdorim të përkohshëm dhe vendosjen e servitutit të kalimit, për pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti “Ndërtimi i pritave të cilat pengojnë vërshimin e lumenjve dhe sigurojnë mbrojtjen e tubacionit, pjesë e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik Pipeline (projekti TAP)”, në zonat Berat, Skrapar dhe Fier.....	10200



LIGJ
Nr. 67/2018

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN
NR. 55/2015 “PËR INVESTIMET
STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 36, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, fjalët “data 31 dhjetor 2018” zëvendësohen me fjalët “data 31 dhjetor 2019”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.10.2018

Shpallur me dekretin nr. 10918, datë 19.10.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

LIGJ
Nr. 68/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES
SË HUAS DHE PROGRAMIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE, FONDIT
SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE KFW
FRANKFURT AM MAIN, PËR
FINANCIMIN E PROGRAMIT “FONDI I
INVESTIMEVE SOCIALE IV”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së huas dhe e programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.10.2018

Shpallur me dekretin nr. 10917, datë 19.10.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë, Shqipëri
Faks: (+355) 4 222 8494

Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga “Sami Frasheri”, nr. 10
Tiranë, Shqipëri

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë

Dokument ndryshues i Marrëveshjes së Huas dhe i Programit ndërmjet KfW Frankfurt am Main, Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, për financimin e “Fondit të investimeve sociale IV”
Marrëveshja e Huas dhe e programit
Datë 23 dhjetor 2010
Vlera: 20 milionë euro
BMZ nr. 2010 65 721
Nr. i llogarisë së Huas: 24916

Datë 30 prill 2018

Banka e Zhvillimit KfW

Eva Niepagenkemper

Referenca jonë: NgE

Nr. tel.: +49 69 7431 - 7655

Faks: +49 69 7431-2944

Eva.Niepagenkemper@kfw.de

Siç është ndryshuar herë pas here (Marrëveshja e Huas dhe e Programit).

Të nderuar zotërinj,

I referohemi Marrëveshjes së lartpërmendur të Huas dhe të Programit dhe shkresave tuaja, ne datat 15 dhjetor 2017 dhe 26 mars 2018, ku kërkonit zgjatje të afatit të disbursimit dhe përshtatje të emërimit dhe adresës së Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë.



Kemi kënaqësinë t'ju informojmë, me anë të kësaj shkrese, se mund ta plotësojmë kërkesën tuaj për zgjatje të afatit të disbursimit deri më 30 tetor 2018. KfW, për të mundësuar përmbylljen e suksesshme të projektit në fjalë, do të marrë përsipër, vetëm për këtë rast, kostot shtesë të rifinancimit të shkaktuara nga shtyrja e afatit të disbursimit.

Rrjedhimisht, ne biem dakord për modifikimet e mëposhtme në Marrëveshjen e Huas dhe të Programit:

Seksioni A. Modifikime të Marrëveshjes së Huas dhe të Programit

Marrëveshja e Huas dhe e Programit do të modifikohet si më poshtë:

1. Sa herë që në të gjithë tekstin e Marrëveshjes së Huas dhe të Programit përmendet emërtimi “Ministria e Financave”, të fshihet dhe të zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”.

2. Neni 3.2, “Afati për kërkimin e disbursimit” të hiqet dhe të zëvendësohet si më poshtë:

“KfW mund të refuzojë disbursimin pas datës 30 tetor 2018.”.

3. Në nenin 13.2, “Adresa e Huamarrësit për dërgimin e njoftimeve” të hiqet dhe të zëvendësohet si më poshtë:

“Për Huamarrësin:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, nr. 3
Tiranë, Shqipëri
Faks: (+355) 4 222 8494”

Seksioni B. Dispozita shtesë

1. Kjo shkresë nuk ndryshon apo tërheq dispozita të Marrëveshjes së Huas dhe të Programit, përveç nëse përcaktohet shprehimisht në këtë shkresë.

2. Dispozitat e nenit 10 (*Kostot dhe pagesat publike*), nenit 11.5 (*Pajtuëshmëria*), nenit 13.2 (*Adresat*), nenit 14.3 (*Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet*), nenit 14.4 (*Forma e shkruar*), nenit 14.6 (*Ligji i zbatueshëm*) dhe nenit 14.9 (*Mosmarrëveshjet ligjore*) të Marrëveshjes së Huas dhe të Programit, të datës 23 dhjetor 2010, të përfshihen në këtë shkresë, sikur të ishin përcaktuar plotësisht në këtë shkresë dhe, sikur referencat në këto pika të Marrëveshjes të ishin referenca për këtë shkresë.

Ju lutem konfirmoni pëlqimin tuaj për ndryshimet e përmendura më sipër, duke

nënshkruar në një formë të detyrueshme ligjore dhe duke i dërguar KfW-së kopjen origjinale.

Përgatitur në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Me respekt,
KfW

Dr. Kirk Mildner
Drejtues Divizioni
Banka e Zhvillimit KfW

Christina Kern
Menaxhere Projekti
Banka e Zhvillimit KfW

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë, 24.7.2018

Tiranë, _____ 2018

Për dhe në emër të
Republikës së Shqipërisë

Për dhe në emër të Fondit
Shqiptar të Zhvillimit

Emri:
Titulli:

Emri:
Titulli:

LIGJ Nr. 69/2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 129, DATË 11.5.2009, “PËR GJENDJEN CIVILE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave dhe të një grupi deputetësh,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, pika 7, pas fjalëve “janë emrat” shtohen fjalët “dhe mbiemrat”.

Neni 2

Në nenin 27, pika 3 ndryshohet si më poshtë:
“3. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes, për shtetasit shqiptarë, për shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, me banim të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të mbajtura nga shërbimi i gjendjes civile i shteteve të huaja ose nga përfaqësitë tona diplomatike apo konsullore atje, përcillen në zyrat e gjendjes civile



përkatëse për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës, nga vetë i interesuari ose nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.”.

Neni 3

Në nenin 33, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Regjistri Kombëtar administrohet nga institucioni përgjegjës i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 4

Në nenin 34 hiqet fjala “bashki”.

Neni 5

Në nenin 36 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Plotësimet dhe korrigjimet në Regjistrin Kombëtar”

2. Pas shkronjës “c” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për korrigjimin si gabim të provuar material të rubrikës së emrit, mbiemrit, emrit të babait, emrit të nënës, ndiqet procedura e parashikuar në nenin 57/7 e vijues të këtij ligji.”.

Neni 6

Pas nenit 38 shtohet neni 38/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 38/1

Akti i lindjes i lëshuar jashtë vendit

1. Në rastet kur akti i lindjes i lëshuar në një shtet tjetër ka të dhëna të paplota ose të pasakta, gjykata bën vërtetimin e faktit juridik të lindjes, me qëllim regjistrimin në zyrat e gjendjes civile.

2. Kërkesën për vërtetimin e faktit juridik të lindjes mund ta paraqesin subjektet e parashikuara në nenin 40 të këtij ligji.

3. Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, në të cilin kanë vendbanimin prindi ose prindërit e fëmijës për të cilin kërkohet regjistrimi.

4. Gjkata që shqyrton çështjen për vërtetimin e faktit juridik të lindjes, merr vendim brenda 45 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, duke thirrur, me cilësinë e personit të interesuar, zyrën e gjendjes civile.

5. Nëse ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ushtrohet ankim, gjykata e apelit shqyrton ankimin, në dhomë këshillimi, brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të tij.”.

Neni 7

Në nenin 40 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, pas fjalëve “organet e njësisë së qeverisjes vendore” shtohen fjalët “njësitë për mbrojtjen e fëmijës”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Nëse deklarimi i lindjes së fëmijës nuk kryhet brenda 60 ditëve nga lindja, nga personat e përcaktuar në pikën 1, deklarimi kryhet nga subjektet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj dispozite përcaktohen me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.”.

Neni 8

Në nenin 41 bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi i lindjes mund të bëhet edhe në përfaqësitë diplomatike ose konsullore shqiptare në vendin ku ka ndodhur lindja.”.

2. Pika 6 shfuqizohet.

Neni 9

Pas nenit 41 shtohet neni 41/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 41/1

Raportimi dhe regjistrimi i lindjeve me procedurë të veçantë

1. Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore, publike dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara që, për çdo lindje të ndodhur pranë institucioneve të tyre, të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, dokumentacionin/njoftimet përkatëse. Ky proces kryhet çdo ditë të hënë, për javën pararendëse.

Modalitetet, lloji i dokumentacionit, forma dhe mënyra e komunikimit ndërmjet këtyre



institucioneve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrave përkatës që mbulojnë institucionet e lartpërmendura.

2. Për çdo lindje të raportuar, sipas pikës 1, të këtij neni, zyra përkatëse e gjendjes civile pasqyron lindjen në regjistrin e përkohshëm.

Ministri përgjegjës për gjendjen civile përcakton me udhëzim rregulla të hollësishme për krijimin dhe administrimin e regjistrit të përkohshëm të lindjeve të raportuara.

3. Nëse regjistrimi i lindjes së fëmijës nuk kryhet brenda 60 ditëve nga data e lindjes, nëpunësi i gjendjes civile informon njësinë për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë vendore, e cila ndërmerr veprimet konkrete për vlerësimin e situatës dhe regjistrimin e lindjes në zyrën e gjendjes civile.

Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj dispozite përcaktohen me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.”

Neni 10

Në nenin 45, pas pikës 3 shtohet pika 3/a me këtë përmbajtje:

“3/a. Kur në aktin e lindjes të mbajtur jashtë vendit është e paplotësuar rubrika e emrit, plotësimi i saj bëhet në përputhje me procedurën administrative, të përcaktuar me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.”

Neni 11

Në nenin 46, pika 1, hiqen fjalët “njësi administrative”.

Neni 12

Në nenin 52 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) në rastin kur ka përfunduar afati i parashikuar në pikën 3, të këtij neni, dhe nuk është bërë deklarimi i vdekjes nga subjektet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, i ngarkuari i posaçëm i bashkisë bën deklarimin në zyrën e gjendjes civile, ku shtetasi që ka ndërruar jetë ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin në momentin e vdekjes.”

2. Në fund të pikës 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile me

ministrat që mbulojnë institucionet e përmendura në këtë pikë.”

3. Pika 9 shfuqizohet.

Neni 13

Në nenin 53, pika 1, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt edhe në rastet kur me vendim gjyqësor të shkallës së parë vërtetohet fakti juridik i vdekjes. Kërkesën për vërtetimin e faktit juridik të vdekjes kanë të drejtë ta bëjnë subjektet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 52, të këtij ligji.”

Neni 14

Në nenin 56, pika 1, fjalët “në juridiksionin e së cilës ka ndodhur lindja” zëvendësohen me fjalët “që ka detyrimin e mbajtjes së aktit të lindjes”.

Neni 15

Në nenin 60, pika 1, në fjalinë e tretë, hiqet fjala “administron”.

Neni 16

Në nenin 61, shkronja “c”, hiqen fjalët “njësi administrative”.

Neni 17

Në nenin 62 hiqen fjalët “njësi administrative”.

Neni 18

Në nenin 63, pika 3, hiqen fjalët “njësi administrative”.

Neni 19

Pas nenit 64 shtohet neni 64/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 64/1

Marrëdhënia e punës e nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile

Marrëdhënia e punës e nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile në bashki dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile, pranë prefektit të qarkut, rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës.”



Neni 20

Në nenin 65 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjat “d” dhe “g” hiqen fjalët “njësi administrative”.
2. Shkronja “c” shfuqizohet.

Neni 21

Në nenin 68, pikat 2 dhe 3, hiqen fjalët “njësisë administrative”.

Neni 22

Në nenin 69 bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në shkronjën “a”, në fund të fjalisë, shtohen fjalët “dhe ofrojnë shërbimin e gjendjes civile për shtetas që kanë vendbanimin brenda juridiksionit territorial të tyre”.

2. Shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:
“dh) informojnë kryetarin e bashkisë, si dhe zyrat e arkivit të gjendjes civile, pranë prefektit të qarkut, për veprimtarinë e tyre, sipas kërkesës së tyre.”.

Neni 23

Në nenin 70, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) administron arkivin e regjistrave dhe të akteve të gjendjes civile të njësisë administrative nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës”.

Neni 24

Në nenin 74, pika 1, bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a”, pas fjalëve “në nenin 52”, hiqet numri “3”.
2. Në shkronjën “b”, fjalët “në nenin 41, pika 6,” zëvendësohen me fjalët “në nenin 41/1, pika 1.”.

Neni 25

Dispozitë kalimtare

Gjoka e parashikuar për shkeljen ose mosrespektimin e dispozitës së përcaktuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të nenit 74, të ligjit, pezullohet për 6 muaj, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 26

Aktet nënligjore

Ngarkohet ministri përgjegjës për gjendjen civile për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 9, 10, dhe 12, të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 11.10.2018

Shpallur me dekretin nr. 10916, datë 19.10.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

VENDIM

Nr. 600, datë 9.10.2018

**PËR MIRATIMIN E SHËRBIMIT
TË SIGURISË PUBLIKE NË 150
INSTITUCIONE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR DHE TË
KRITEREVE PËR OFICERËT
E SIGURISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 37, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 (njëqind e pesëdhjetë) institucione të arsimit parauniversitar, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, që konsiston në monitorimin nga oficeri i sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar të ndërveprimit të vazhdueshëm të nxënësve, personelit mësimor dhe komunitetit.

2. Shërbimi i sigurisë publike në institucionet e sistemit arsimor parauniversitar, siguron:

a) Përmirësimin e sigurisë faktike dhe të perceptuar në ambientet e shkollave dhe ambientet përreth, nëpërmjet krijimit të figurës së oficerit të sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar;

b) Garantimin e një mjedisi të sigurt për nxënësit brenda në shkollë si dhe në territorin përreth saj;

c) Parandalimin e dukurive negative që në gjenezë, duke evidentuar dhe ndërmarrë hapa korrektues, në bashkëpunim me personelin mësimor, psikologun/en e shkollës dhe prindërit;



ç) Forcimin e bashkëpunimit me oficerët e policimit në komunitet;

d) Përmirësimin e perceptimit të oficerit të sigurisë të nxënësit dhe të marrëdhënieve ndërmjet tyre e policisë.

3. Akademia e Sigurisë, si institucioni përgjegjës i vetëm për arsimin e lartë policor, që ka për qëllim formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe ofrimin e specializimeve e të kualifikimeve për institucione të tjera të zbatimit të ligjit, për personat fizikë dhe juridikë në fushën e rendit e të sigurisë publike, të përgatisë dhe trajnojë oficerët e sigurisë për institucionet e arsimit parauniversitar.

4. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përzgjedhur oficer sigurie janë, si më poshtë vijon:

a) Të jetë shtetas shqiptarë;

b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

ç) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) Të mos ketë marrë masën disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë;

dh) Të ketë diplomë të ciklit të dytë ose diplomë të barasvlershme me të në fushën e edukimit, të shkencave sociale, sociologjisë, psikologjisë, drejtësisë;

e) Të jetë jo më shumë se 40 vjeç;

ë) Të ketë njohuri të mira kompjuterike.

5. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit, konkurrimit dhe shpallja e rezultateve të konkurrimit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

6. Marrëdhëniet e punës së oficerëve të sigurisë fillojnë pas përfundimit me sukses të trajnimit pranë Akademisë së Sigurisë dhe rregullohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.

7. Numri i oficerëve të sigurisë dhe shpenzimet përkatëse përballohen brenda numrit total të punonjësve dhe fondeve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI NR. 1

Nr.	Institucioni arsimor	Vendndodhja	Numri i nxënësve
1	"Ismail Qemali"	Tiranë qytet	1720
2	"Ibrahim Rugova"	Kamzë	1477
3	"Sami Frashëri"	Tiranë qytet	1419
4	"P. N. Luarasi"	Tiranë qytet	1291
5	"Qemal Stafa"	Tiranë qytet	1263
6	"Havzi Nela"	Kukës	1207
7	"Shote Galica"	Fushë-Krujë	1134
8	"Janaq Kilica"	Fier	1127
9	"Myslym Keta"	Tiranë qytet	1104
10	"Said Najdeni"	Dibër	1051
11	"A. Z. Çajupi"	Tiranë qytet	1016
12	"Leonik Tomeo"	Durrës	980
13	"Ali Demi"	Vlorë	914
14	"Besnik Sykja"	Tiranë qytet	895
15	"Hydajet Lezha"	Lezhë	885
16	"Partizani"	Tiranë qytet	849
17	"At'Shtjefën Gjeçovi"	Kurbin	833
18	"Naim Frashëri"	Durrës	804
19	"Babë Dudë Karbunara"	Berat	790
20	"Asim Vokshi"	Tiranë	786
21	"Elez Isuf Ndreu"	Kamzë	752



22	“Aleksandër Moisiu”	Kavajë	746
23	“Kostandin Kristoforidhi”	Elbasan	725
24	“Dhaskal Todri”	Elbasan	683
25	“18 Tetori”	Lushnjë	677
26	“Aleks Buda”	Tiranë qytet	676
27	“Jordan Misja”	Shkodër	670
28	“Kostandin Kristoforidhi”	Elbasan	668
29	“Gramoz Palushi”	Paskuqan, Kamzë	666
30	“Skënderbeu”	Has	624
31	“Sinan Tafaj”	Tiranë	621
32	“Hasan Tahsini”	Sarandë	620
33	“Muharrem Çollaku”	Pogradec	614
34	“Isa Adem Boletini”	Tiranë	610
35	“Gjergj Kastrioti”	Durrës	587
36	“28 Nëntori”	Shkodër	584
37	“Ibrahim Muça”	Librazhd	582
38	“Arben Broci”	Tiranë	580
39	“Jordan Misja”	Tiranë	564
40	“Gjergj Pekmezi”	Pogradec	563
41	“Arif Halil Sulaj”	Kurbin	547
42	“Oso Kuka”	Shkodër	543
43	“Asim Vokshi”	Tropojë	522
44	“Bulqizë”	Bulqizë	510
45	“Adem Vrapi”	Roskovec	510
46	“Isa Boletini”	Paskuqan, Kamzë	503
47	“Fuat Babani”	Devoll	501
48	“Shefqet Guzi”	Gramsh	493
49	“Raqi Qirinxhi”	Korçë	491
50	“Themistokli Gërmenji”	Korçë	489
51	“Dervish Hekali”	Mallakastër	483
52	“Pjetër Budi”	Mat	466
53	“Skënderbeu” Krujë	Krujë	455
54	“Shejnaze Juka”	Shkodër	451
55	“5 Tetori”	Kuçovë	441
56	“Eqrem Çabej”	Tiranë qytet	441
57	“Olsi Lasko”	Durrës	437
58	“Perikli Ikonomi”	Fier	437
59	“Muhamer Janina”	Berat	431
60	“Ahmet Dakli”	Elbasan	429
61	“Bernardina Qeraxhia”	Durrës	416
62	“Kristaq Capo”	Berat	409
63	“Vasil Kamami”	Elbasan	402
64	“28 Nëntori”	Mat	381
65	“Maqellarë”	Dibër	380
66	“Halit Berzeshta”	Librazhd	377
67	“Sami Frashëri”	Elbasan	374
68	“Zhani Ciko”	Patos	373
69	“Rrëshen”	Mirditë	373
70	“Avdulla Keta”	Tiranë qytet	370
71	“Siri Shaplo”	Gjirokastër	369
72	“Sherif Hoxha”	Malësi e Madhe	368
73	“Kristaq Capo” Shksh	Berat	366
74	“Miti Zoi Zaka”	Lushnjë	366
75	“16 Shtatori”	Durrës	362
76	“Mustafa Kemal Atatürk”	Peqin	361
77	“Myslim Shima”	Tiranë	359
78	“Shaban Çollaku”	Mat	358



79	“Halim Xhelo”	Vlorë	347
80	“Sandër Prosi”	Tiranë	334
81	“Ramiz Aranitasi”	Skrapar	330
82	“Haxhi Qehaj”	Kavajë	327
83	“Mustafa Hoxha”	Cakran, Fier	323
84	“Mahmut & Ali Cungu”	Elbasan	313
85	“Kutalli”	Berat	312
86	“Sami Frashëri”	Përmet	312
87	“Rifat Manjani”	Bulqizë	308
88	“Zihni Magani”	Peqin	306
89	“Kolë Idromeno”	Shkodër	305
90	“Asim Zeneli”	Gjirokastër	298
91	“Luigj Gurakuqi”	Elbasan	295
92	“Tomorr Sinani”	Elbasan	294
93	“Jani Minga”	Vlorë	274
94	“Maliq”	Korçë	268
95	“Kullë”	Durrës	262
96	“Ibrahim Hasmema”	Tiranë	260
97	“Osman Gjini”	Elbasan	258
98	“Abaz Shehu”	Tepelenë	257
99	Manëz	Durrës	255
100	“Bajram Abdiu”	Kukës	255
101	“Jani Nushi”	Lushnjë	255
102	“Nënë Tereza”	Shkodër	254
103	“Sadik Stvileci”	Tiranë	254
104	“Myslym Shima”	Tiranë	253
105	“Vajdin Lame”	Tiranë	253
106	“Sulejman Delvina”	Delvinë	252
107	“Myrteza Kepi”	Kuçovë	242
108	“Adem Haxhija”	Shkodër	241
109	“Sadi Nuri”	Tiranë	238
110	“Skënderbeu”	Krujë	237
111	“Sali Halili”	Librazhd	235
112	“Milot”	Kurbin	231
113	“Farkë”	Tiranë	231
114	“Ymer Dishnica”	Korçë	226
115	“Qemal Bazelli”	Pogradec	226
116	“Petro Nini Luarasi”	Kolonjë	225
117	“Pirg”	Korçë	222
118	“Sukth i Ri”	Durrës	221
119	“Kastriot”	Dibër	214
120	“Katund i Ri”	Durrës	214
121	“Mustafa Qemal Atatürk”	Vlorë	213
122	“Loro Boriçi”	Tiranë	212
123	“At’Shtjefën Kurti”	Kurbin	210
124	“Sabah Sinani”	Pukë	209
125	“Gosë”	Kavajë	207
126	“Miranda Baku”	Elbasan	204
127	“Sulejman Elezi”	Kamzë	204
128	“Anastas Çakalli”	Elbasan	202
129	“14 Engjëjt”	Pogradec	201
130	“Mahir Domi”	Elbasan	200
131	“Llesh Nik Daka”	Lezhë	200
132	“Faik Konica”	Korçë	197
133	“Vath Koreshi”	Lushnjë	197
134	“Fushë-Arrëz”	Pukë	196
135	“Hajredin Fratar”	Mallakastër	193



136	“Hydajet Lezha”	Lezhë	189
137	“Dom Nikoll Kacorri”	Durrës	188
138	“Vaqarr”	Tiranë	178
139	“Luz i Vogël”	Kavajë	174
140	“Jovan Ndreko”	Fier	168
141	“Syzes”	Berat	167
142	“Karl Gega”	Lezhë	167
143	“Besnik Hidri”	Durrës	163
144	“Dilaver Nezha”	Librazhd	162
145	“Dodë Kaçaj”	Malësi e Madhe	161
146	“Fiershegan”	Lushnjë	157
147	“Nikollë Zogoriani”	Shkodër	157
148	“Mustafa K. Atatürk”	Kamzë	151
149	“Bubq”	Krujë	150
150	“Muhamet Kondi”	Poliçan	150

UDHËZIM

Nr. 698, datë 17.10.2018

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR NGRITJEN DHE ULJEN E HELIKOPTERËVE JASHTË ZONAVE TË AERODROMEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7(ç) dhe të nenit 77, të ligjit 10040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Ky udhëzim përcakton kushtet dhe procedurat për kryerjen e operimeve individual, kohë pas kohe, të ngritjes dhe të uljes së helikopterëve, në vendet që janë jashtë zonave të aerodromeve të miratuara apo të certifikuara, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Ky udhëzim nuk do të zbatohet:

2.1 Për operimet me helikopter, me qëllim të ngritjes apo të uljes nga sipërfaqet e ngritura, siç janë kulmet e ndërtesave, zonat e ndërtimit.

2.2 Për operimet e helikopterëve, me qëllim të ngritjes apo të uljes, në rast të:

- Uljeve në raste emergjente;
- Ofrimit të ndihmës emergjente mjekësore;
- Marrjes pjesë në operimet e kërkimit dhe të shpëtimit;
- Marrjes pjesë në fiksje të zjarrit; dhe
- Fluturimeve të ndërhyrjeve të veçanta.

2.3 Për operimet për ngritjen dhe uljen e helikopterëve ushtarakë jashtë zonave të aerodromeve.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij udhëzimi, përkufizimet dhe shkurtimeve kanë kuptimet si më poshtë:

1. “AAC” nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë, të rregulluar sipas ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar.

2. “Aerodrom” nënkupton një zonë (duke përfshirë çdo ndërtesë, instalim dhe pajisje) të përcaktuar në tokë ose mbi ujë, ose mbi një strukturë fikse në tokë, fikse në det ose strukturë lundruese, që përdoret tërësisht ose pjesërisht për mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen e avionëve në sipërfaqe, ku përfshihen edhe heliportet dhe fushat e fluturimit. “Heliport” nënkupton një aerodrom apo një zonë të caktuar në ndonjë strukturë që ka për qëllim të shfrytëzohet plotësisht apo pjesërisht për ngritje, ulje dhe lëvizje vetëm të helikopterëve.

3. “Hapësira për ngritje dhe ulje” nënkupton sipërfaqen e cila mundëson ngritjen apo uljen e helikopterit.

4. “Operator i helikopterit” nënkupton çdo pronar ose qiramarrës, në bazë të një kontrate qiraje ose përfaqësues respektiv të autorizuar ligjërisht, i cili operon helikopterin.

5. “Pronar” nënkupton personin, i cili në përputhje me Kodin Civil dhe dispozitat që rregullojnë institutin e pronësisë, ka të drejtën e gëzimit dhe të disponimit lirisht të vendit natyror apo çdo person tjetër i cili ka të drejta reale mbi të.



6. “Sipërfaqe e ngritur” nënkupton zonën e caktuar për ulje apo për ngritje të helikopterëve, të vendosur në ndonjë ndërtesë ose strukturë të ngritur mbi nivelin e sipërfaqes së tokës.

7. “Vend natyror për uljen dhe ngritjen e helikopterit (VNUH)” nënkupton një zonë që nuk është e licencuar dhe e certifikuar për uljen dhe ngritjen e helikopterëve.

8. “Zonë e kontrolluar” nënkupton hapësirën ajrore të kontrolluar që shtrihet nga sipërfaqja e tokës deri në një kufi të sipërm të përcaktuar.

9. “Zonë e banuar” nënkupton qytet, qytezë, fshat apo ndonjë zonë që përdoret për qëllime të banimit publik, privat apo qëllime rekreative.

10. “Zonë e sigurt” nënkupton një zonë të veçantë rreth VNUH-së, në të cilën nuk ka pengesa, me përjashtim të atyre që janë të nevojshme për navigim dhe që shërbejnë për të zvogëluar rrezikun e dëmtimit të helikopterit, në rast të ngritjes në mënyrë të pakontrolluar nga VNUH-ja.

11. Shkurtime:

“A”	Diametri i rotorit të helikopterit;
“MFA”	Manuali i fluturimit të mjetit ajror;
“B”	Distanca ndërmjet rrotave, skive ose pajisjeve lundruese të helikopterëve;
“PKV”	Pika kritike e vendimit;
“CTR”	Zona e kontrolluar;
“D”	Gjatësia maksimale e helikopterit;
“Ft”	Këmbë (1 ft = 0.304 metra);
“VNUH”	Vend natyror për uljen dhe ngritjen e helikopterëve;
“HUN”	Hapësira për ulje dhe ngritje;
“HS”	Hapësira e sigurisë (<i>safety</i>);
“VFR”	Rregullat e fluturimit vizual;
“Vy”	Shpejtësia më e mirë e ngritjes.

Neni 3

Dispozita të përgjithshme

1. Ulja dhe ngritja e helikopterëve nga dhe për në VNUH mund të kryhet vetëm nëse vendet natyrore për ulje dhe ngritje të helikopterëve janë në përputhje me parashikimet e këtij udhëzimi.

2. Nëse ngritja dhe ulja është kryer nga VNUH-ja, të cilat gjenden brenda zonave të kontrolluara (CTR), është e nevojshme të merret miratimi i kontrollit të trafikut ajror para ngritjes.

3. Operatorët e helikopterëve të angazhuar në operime tregtare duhet të përshkruajnë në

manualin e operimit procedurat për zgjedhjen e VNUH-së, në përputhje me kufijtë e klasës së performancës së helikopterit, të përcaktuara sipas procedurave përkatëse.

4. Operatorët e autorizuar të helikopterëve të përfshirë në operimet ajrore jo të rregullta (*charter*), private, taksi dhe/apo panoramike, nuk mund të përdorin VNUH më tepër se katër (4) ditë të njëpasnjëshme, brenda periudhës tridhjetëditore (30-ditore).

5. Ngritja dhe ulja e helikopterëve nga VNUH-ja nuk lejohet në transportin e rregullt ajror.

6. Ngritja dhe ulja e helikopterëve nga VNUH-ja nuk lejohet brenda zonave të banuara dhe në një distancë më të vogël se 150 m (500 ft) nga zonat e banuara.

Neni 4

Eksperiencia e pilotit

Ngritjen dhe uljen e helikopterit nga VNUH-ja mund ta kryejë piloti i helikopterit, i cili posedon licencë të vlefshme për tipin, klasifikimin e tipit të helikopterit, si dhe të ketë së paku tri (3) ngritje dhe ulje brenda 90 ditëve të fundit.

Neni 5

Pëlqimi për shfrytëzim

1. Operatori i helikopterit, përpara aplikimit në Autoritetin e Aviacionit Civil dhe përpara përdorimit të VNUH-së, duhet të marrë pëlqimin me shkrim të pronarit apo cilitdo personi tjetër fizik dhe juridik, që gëzon të drejta reale mbi atë pronë dhe ta paraqesë atë në AAC, së bashku me aplikimin të paktën 5 ditë para operimit.

2. Pronari apo personi tjetër fizik apo juridik, sipas paragrafit 1 të këtij neni, është përgjegjës për zbatimin e rregullave dhe/ose të kërkesave të përcaktuara nga pushteti lokal apo qendror, për territorin ku gjendet kjo sipërfaqe, siç është rasti i parqeve natyrore, parqeve kombëtare, zonave të mbrojtura, por jo vetëm.

Neni 6

Njoftimi për përdorimin

Operatori i helikopterit, përpara operimit në një VNUH, duhet të njoftojë organet përkatëse të pushtetit vendor dhe Drejtorinë Rajonale të



Policisë, për qëllimin e përdorimit të VNUH-së, kohën e parashikuar të fillimit dhe të përfundimit të operimit.

Neni 7

Miratimet

1. Operatori i helikopterit, për të kryer operimet e ngritjes dhe të uljes së helikopterëve nga VNUH-ja, paraprakisht duhet të marrë miratim. Miratimi jepet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në bazë të kërkesës së operatorit të helikopterit.

2. Kërkesa për miratim, sipas paragrafit 1 të këtij neni, me dokumentacionin përkatës, duhet të dorëzohet të paktën 5 (pesë) ditë pune para operimit, duke përdorur formatin e aplikimit sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

3. Miratimi, siç referohet në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, do të listojë edhe pilotët që mund të kryejnë ngritjen dhe uljen e helikopterëve nga VNUH-ja dhe do të paraqesë kushtet dhe kufizimet shtesë të nevojshme për të siguruar kryerjen e operimeve të sigurta.

4. Miratimi për ngritje dhe ulje të helikopterëve nga VNUH-ja, varësisht nga lloji i operimeve që operatori ka për qëllim të kryejë, mund të lëshohet për një periudhë deri në një vit.

5. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të refuzojë lëshimin e miratimit sipas paragrafit 1 të këtij neni ose të tërheqë miratimin e lëshuar, nëse zbulon që kushtet e përshkruara nuk janë plotësuar.

6. Rregullat që përcaktojnë afatet e aplikimit dhe të trajtimit të kërkesës për të marrë miratimin për të kryer operimet e ngritjes dhe të uljes së helikopterëve nga VNUH-ja, si procedurën që ndiqet në rast të refuzimit apo të heqjes së miratimit, përcaktohen nga AAC-ja.

Neni 8

Rregullat e fluturimit

1. Fluturimet e helikopterëve do të kryhen vetëm ditën, nga koha e lindjes deri në perëndimin e diellit, sipas rregullave në fuqi të fluturimit vizual (VFR) në hapësirën ajrore të klasës C, D dhe G.

2. Në rast të fluturimeve për në, dhe nga VNUH-ja që ndodhen brenda zonave të kontrolluara (CTR) apo në afërsi të kufirit shtetëror, të fluturimeve që kalojnë përmes kufijve lateralë të zonave të kontrolluara (CTR ose TMA)

dhe të zonave të tjera të rezervuara ose të kufizuara të publikuara në AIP ose me NOTAM, piloti ose operatori i helikopterit duhet të plotësojë një plan fluturimi sipas formatit të ICAO-s dhe ta paraqesë atë pranë ofruesit të shërbimit të lundrimit ajror, njësisë përkatëse (ARO), dorazi ose me *e-mail*, ose me faks, të paktën 60 minuta përpara ngritjes. Në rrethana specifike, plani i fluturimit mund të plotësohet në ajër me anë të radiokomunikimit me njësinë përgjegjëse të kontrollit të trafikut ajror (), të paktën 10 minuta përpara hyrjes në zonën e kontrolluar.

3. Në planin e fluturimit, piloti ose operatori i helikopterit duhet të paraqesë pikat e përcaktuara të hyrjes apo të daljes nga zonat e kontrolluara.

4. Operimet e helikopterëve, në kushtet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, do të kryhen pas marrjes së klierencës nga njësia e kontrollit të trafikut ajror përpara ngritjes.

5. Të gjitha ndryshimet në planin e fluturimit duhet të raportohen dhe të kryhen pas marrjes së klierencës nga njësia përgjegjëse e shërbimit të trafikut ajror.

6. Lartësia e fluturimit të helikopterëve brenda ose përmes CTR-së dhe nën kufirin e poshtëm të TMA-së nuk duhet të jetë më e madhe se 600 m nga niveli i detit.

7. Helikopterët që operojnë në hapësirën ajrore të klasës C dhe D, duhet të jenë të pajisur me radio komunikimi të dyanshëm, transponder SSR dhe pajisje të tjera të nevojshme për navigimin ajror.

8. Helikopterët që operojnë në hapësirën ajrore të klasës G, duhet të fluturojnë jashtë zonave të kontrolluara, të rezervuara ose të kufizuara në një largësi horizontale nga kufijtë lateralë të tyre jo më të vogël se 2.5 NM.

Neni 9

Vendi natyror për uljen dhe ngritjen e helikopterëve

1. Operatori i helikopterit nuk mund të përdorë VNUH-në, e cila nuk i plotëson kushtet e mëposhtme:

a) VNUH-ja duhet të ketë një sipërfaqe që është e barabartë me ose më e madhe se sipërfaqja e një drejtkëndëshi, që është marrë si rezultat i shumëzimit të 1.5 D x D, ku D është gjatësia maksimale e helikopterit;

b) Sipërfaqja e VNUH-së duhet të jetë rezistente nga efekti i rotorëve dhe e lirë nga çdo



parregullsi, të cilat mund të ndikojnë në ngritjen dhe uljen e helikopterëve në mënyrë të jo favorshme;

c) HUN-ja duhet të ketë kapacitet të ngarkesës e cila mund të përballojë peshën totale të helikopterit që do të përdoret;

d) HUN-ja duhet të jetë më e madhe se sa sipërfaqja e diametrit apo, së paku 0.83 D e helikopterit më të madh që do të përdoret;

e) VNUH-ja duhet të ketë përçark hapësirën e sigurisë (HS), gjerësia e së cilës nuk është më e vogël se 10 metra;

f) Nuk lejohet asnjë objekt fiks në hapësirën e sigurisë së VNUH-së, përveç objekteve të thyeshme/të lakuara, të cilat janë të domosdoshme të vendosen në këtë hapësirë. Në asnjë mënyrë nuk lejohet vendosja e objekteve të lëvizshme në hapësirën e sigurisë gjatë operimeve të helikopterëve;

g) Sipërfaqja brenda hapësirës së sigurisë (HS) duhet të jetë e përshtatshme për ulje të detyruar.

2. Ngritja dhe ulja nga VNUH-ja ekskluzivisht, duhet të kryhet gjatë ditës, sipas Rregullave të Fluturimit Vizual (VFR). Nëse ngritja dhe ulja është kryer nga VNUH, të cilat gjenden brenda zonave të kontrolluara (CTR), është e nevojshme të merret miratimi i kontrollit të trafikut ajror para ngritjes.

3. Në sipërfaqen ku kryhen ngritjet dhe uljet duhet të ketë së paku një pajisje 12 kg që shërben për fikjen e zjarrit, e cila është e shenjëzuar, në mënyrë të qartë dhe e vendosur në mënyrë që të mund të përdoret shpejt në rast të zjarrit. Kutia e ndihmës së shpejtë duhet të ketë shenjëzim të qartë dhe të jetë në afërsi të duhur, nëse nevojitet për përdorim. Kutia e ndihmës së shpejtë duhet të mirëmbahet sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe të plotësohet pas çdo përdorimi.

Neni 10

Vështrimi i terrenit

1. Para se të ulet në VNUH, piloti komandues, përmes metodës së mbifluturimit, duhet të përcaktojë si më poshtë:

a) Drejtimin e erës;

b) Mundësinë e mbajtjes së nivelit në përafrim dhe në ngritje;

c) Përshtatshmërinë e VNUH-së dhe të hapësirës së sigurt për ulje të detyruar;

d) Mundësinë e kalimit të pengesave.

2. Piloti komandues i helikopterit nuk mund të

përdorë VNUH-në, nëse ka njerëz, kafshë, automjete, instalime apo objekte të ngjashme të vendosura në një distancë më të vogël se 3 A, ku A është diametri i rotorit të helikopterit.

Neni 11

Afrimi dhe nisja

